REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:197367
Datë: 09.01.2020
Numri i dokumentit: 00792370

C.nr.1023/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike të paditësit SH.H, Shtimja Rr.”.....”, të cilin e përfaqëson av.K.A kundër të paduruës Komuna Shtime – Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim L.M, në çështjen për pagesën e pagave përcjellëse dhe jubilare, pas mbajtjes të shqyrtimin gjyqësor me dt.09.01.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit SH.H nga ....., e paraqitur kundër të paduruës Komuna Shtime Drejtoria Arsimit, me të cilën është kërkuar që të **DETYROHET** e paditura paditësit ti paguaj në emër të tri pagave përcjellëse në pension shumën 1.204,77€ dhe në emër të tri pagave jubilares shumën prej1.204,77€ apo shumën e përgjithshme prej 2,409.54€, (dy mijë e katërqind e nëntë euro e pesëdhjetë e katër cent) si e pa bazuar.

Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, precizimit të saj duke shtuar se meqenëse ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura e njëjta ka detyrim që paditësi me rastin e daljes në pension t’ia paguaj tri paga përcjellëse në pension dhe tri paga jubilare, të cilën gjë nuk e ka bërë pasi që me kontratën kolektive e ka përcaktuar se punëdhënësi i fundit është ai i cili e ka për detyrim e në rastin konkretë punëdhënësi i fundit i paditëses ka qenë e paditura

Sa i përket pretendimit të paduruës se paditësi ka qenë i suspenduar nga marrëdhënia e punës për shkak se ka qenë i akuzuar për vepër penale, ka theksuar se e paditura nuk ka prova që ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit, por edhe përkundër kësaj ka theksuar se paditësi nga

2019:197368

vendimi i pezullimit nuk ka punuar askund tjetër deri me rastin e daljes në pensin para muajit mars 2015 kur i ka mbushur 43 vite përvojë pune

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të padituröes në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi duke shtuar se paditësi ka punuar tek e paditura deri me datën 13.02.2015, periudhë të cilën i njëjti është arrestuar për vepër penale dhe mbi këtë bazë e paditura ka marr vendim me të cilin të padituri e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës, sa i përket kontratës kolektive ka theksuar se e njëjta e ka rregulluar faktin se pagat jubilare dhe përcjellëse ia paguan punëdhënësi i fundit në rastin konkretë ka theksuar se nuk ka qenë punëdhënësi i fundit, arsyeja e mos nxjerrjes së vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës ka theksuar ka qenë për faktin se me vendimin mbi pezullimin është specifikuar se do ti ndërpritet kur të njoftohet nga ana e gjykatës në lidhje me formën e prerë të aktgjykimit.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë ushtrimin e provave U lexua vendimi lëshuar nga MPMS datë 14.07.2017, lëshuar në emër të paditësit fotokopje, vërtetimi lëshuar nga SHFMU “.....” me nr. 34/1 datë 10.02.2015, vërtetimi lëshuar nga SHFMU “.....” nr. 02/358 dt.15.04.2014, listat e pagës për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2014, autorizimi i paditësit dhënë av.K.A dt.31.08.2019, vendimi lëshuar nga e paditura nr. protokolli 05/30 dt.13.02.2015, lista e pagave për muajt gusht, shtator dhe tetor 2015,

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mes palëve se paditësi ka arritur moshën 65 vjeçare më datë 25.05.2017, por kontestuese është se a i takon e drejta në kompenzimin e tri pagave përcjellëse dhe tri pagave jubilare apo jo paditësit me rastin e daljes në pension.

Gjykata nga deklarata e palëve ndërgjygjëse ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës dhe i njëjti para daljes në pension me vendim i është pezulluar marrëdhënia e punës në vitin 2015, për shkak se është dyshuar se ka kryer

2019:197368

vepër penale në vendin e punës dhe që lidhet me marrëdhënien e punës dhe në vitin 2015 ka pasur përvojë pune 39 vite, por duke marr parasysh datën e pensionimit të tij gjykata konsideron se në atë periudhë nuk ka qenë në fuqi Kontrata e kolktive e Arsimit Parauniversitar e cila me dispozita ligjore të nenit 36 par.9 dhe 10 e ka rregulluar pagat jubilare dhe përcjellëse për faktin se e njëjta ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2005, ka qenë e aplikuar për tri vite, që do të thotë se e njëjta ka qenë në fuqi deri më 31.12.2007, kurse paditësi ka dalur në pension me datën 25.05.2017, në ët cilën periudhë nuk ka qenë i punësuar tek e paditura dhe nuk ka qenë në fuqi Kontrata e Arsimit, e datës 11.04.2014, mbi bazën juridike të cilën është thirrur paditësi se i takojnë.

Sa i përket pretendimit të paditësit se i njëjti në vitin 2015 i ka pasur mbi 39 vite prëvojë pune dhe i takon e drejta në tri paga përcjellëse dhe tri pagave jubilare gjykata konsideron se duke u nisur nga lista e pagave të muajt Gusht, Shtator dhe Tetor të vitit 2015, rezulton se paditësi në atë periudhë ka pasur përvojë 39 vite, përvojë pune por duke u bazuar në neni 36 par.9 i kontratës kolektive thuhet Punëtorët (anëtarët e .....) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar, kurse në par.10 thuhet punëtorët (anëtarët e .....) që dalin në pension përfitojnë pagesën përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, andaj në rastin konkretë paditësi me rastin e daljes në pension fillimisht nuk ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për shkak se me aktgjykimin e kësaj Gjykate PKR.nr.67/16 e datës 03.03.2017, është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 viteve kurse me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.213/17 dënim i është zbutur në 8 vite, përveç kësaj paditësi me rastin e arritjes së moshës prej 65 vite periudhë të cilën do të kishte përfituar eventualisht nga Kontrata Kolektive siç parashihet me nenin 36 par.9 dhe 10, por kjo kontratë nuk ka qenë në fuqi, por ka qenë Kontrata Kolektive e datës 18.04.2017, por meqenëse me rastin e hyrjes në fuqi të kontratës së re Kolektive paditësi nuk ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura andaj, gjykata konsideron edhe në rastin konkretë paditësi nuk mundet me përfituar as sipas Kontratës së re Kolektive për shkak se në këtë periudhë nuk ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj dhe rrjedhimisht gjykata konsideron se nuk ekziston baza ligjore në lidhje me pretendimin e paditësit për pagesën e tri pagave jubilare dhe tri paga përcjellëse përcjellëse.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, ka vendosur që secila palë ti bart shpenzimet e vet të procedurës

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.1023/19 dt.09.01.2020

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE, Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit të kopjes, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

2019:197368